



Urdhër nr.256, datë 10.04.2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar **Urdhrin nr 256** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr.193 datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e levizjeve në Republikën e Shqipërisë” (**Urdhër 256**)

Në Urdhrin nr.193 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00-17:30 duke filluar nga dita e hënë, date 13.04.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.
- Hyrja në aktivitetet e mësipërme lejohet vetëm për një person të autorizuar, për çdo familje për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një here në ditë dhe do të ketë një afat prej 90 minutash, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30;
- Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitet tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion desinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësitet tregtare.
- Kufizohet lëvizja, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë duke filluar nga e premtja ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitet kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si dhe shërbimet në banesë (delivery).
- Ndalohet ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuar si më lart, duke filluar nga e premtja 17.04.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Order no. 256, dated 10.04.2020

The Ministry of Health and Social Protection has published **Order No. 256** *“On some additions and changes to the Order no. 193 dated 20.03.2020 On the closure or restriction of movements in the Republic of Albania” (Order 256)*

The following changes are made to Order No. 193:

- Grocery stores, including retail and wholesale points, drugstores, medical products and financial institutions are allowed to carry out their activity only at the time period 05: 00-17: 30 hours starting from Monday, 13.04.2020.
- Entry into the above activities is allowed for an authorized person, for each family to carry out daily family expenses. The authorization will be valid once a day and will have a term of 90 minutes, during the time band 05:00 to 17:30;
- Access to all stores / commercial units that are allowed to be opened should be done in a row, maintaining a safety distance of 1.5 m from each other. Each store / commercial unit must provide masks and gloves for employees during the exercise of the activity and a disinfectant solution for all persons entering the premises of the store / commercial units.
- Restriction of movement in all urban centers of the Republic of Albania, for all categories (pedestrians, bicycles, motor vehicles and vehicles) as well as the prohibition of providing services to citizens from the allowed activities, every weekend starting from Friday at 17: 30 to Monday at 05:00. Excluded from this rule are all means of transportation of goods and food products, the State Police, the Armed Forces, critical units of state and media services, as well as home services (delivery).
- It is prohibited to provide services to citizens from all activities, including those defined above, starting from Friday 17.04.2020 and onwards, from 17:30 to Monday at 05:00, until further notice.

This order enters into force immediately.